

Nr. 7006 Prot
Datë 21.12.2023

BASHKIA VORE PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

.



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

PROJEKT BUXHETI RISHIKUAR 2024- 2026 BASHKIA VORË

Bashkia Vorë në 2024 do të jetë një qëndër e rëndësishme kombëtare, një portë që lidh dy qytete më të rëndësishme të vendit tonë Durrësin dhe Tiranën. Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qëndër primare me një cilësi të lartë jetese ku pozita gjeografike e saj dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Vorë. Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal. Vora me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi.

Për këtë arsye Projekt-Buxheti do t'i shërbejë përpjekjeve në vazhdim për të përmbushur vizionin e Strategjisë Territoriale për Zhvillim si më poshtë vijon:

- Përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë për të gjithë, përmes financimit me fondet e veta, në fondet ndërkombëtare dhe të donatorëve, aksesit në fondet qeveritare;*
- Përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve publike: menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit, ndriçimit rrugor, furnizimit me ujë të pijshëm, hapësirve të gjelbra, etj.*
- Përmirësimin e levizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë; - Përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e territorit të Bashkisë Vore;*
- Promovimin e produkteve vendore, nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.*
- Mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve;*
- Projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirë administrimin e infrastrukturës së ndërtuar.*
- Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.*
- Ruajtjen dhe promovimin i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të Bashkisë Vorë.*



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

– Sigurimin e ambjenteve dhe mjediseve të përshtatshme arsimore, të sigurta dhe drejt përmbushjes së standarteve ligjore.

– Krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminim për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.

– Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

Transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, qeverisja me pjesëmarrje, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrjet me efikasitet, përdorimi me efikasitet i fondeve, Instrumentet e rinj të administrimit, përmes përdorimit të teknologjisë bashkohore, procedurave dhe rregullave që do të vijojmë të zhvillojmë, janë principet dhe mënyra e punës tonë. Nëpërmjet këtij dokumenti synojmë të informojmë çdo banor kudo, publikun e gjerë, qeverinë dhe partnerët, lidhur me parashikimet afatmesme dhe afatgjatë të shpenzimeve të Bashkisë Vorë.

“Besoj që të gjithë bashkë, me shumë punë e përkushtim, do të vazhdojmë të përmbushim përgjegjësitë për të administruar, shërbyer dhe zhvilluar Vorën”.



Përmbajtja

HYRJE	5
KAPITULLI I –VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	5
1.1. Situata e njësisë së vetëqeverisjes Vendore	5
1.2. Prespektiva Financiare	7
1.3. Prioritetet e Projekt-Buxhetit	7
KAPITULLI II. TË ARDHURAT E BASHKISË VORË PËR VITIN 2024	
2.1. Të Ardhurat e Veta.....	11
2.1.1. Të ardhurat nga taksat vendore	12
2.1.2. Të ardhurat nga tarifat vendore.....	15
2.1.3. Të ardhura nga burime të tjera.....	18
2.2. Të ardhurat nga burimet qëndrore.....	18
2.2.1. Transferta e Pakushtëzuar	19
2.2.2. Transfertat e pakushtëzuar sektoriale (specifike)	19
2.2.3. Transferta e Kushtëzuar	19
2.2.4. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.....	20
KAPITULLI III. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024	21
3.1. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike	21
3.1.1. Shpenzime kapitale	22
3.1.2. Shpenzime korente.....	22
3.1.3. Fondi rezervë dhe kontigjenca	22
3.1.4. Mbrojtja Civile.....	22
3.1. SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE	23
3.2.1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim (01110)	23
3.2.2. Gjendja Civile	23
3.1.3. Shërbimet e Poliscisë Vendore	24
3.1.4. Mbrojtja nga Zjarri.....	24
3.1.5. Shërbimet Bujqësore, Inspektimi dhe Ushqimi	24
3.1.6. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	25
3.1.7. Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	25
3.1.8. Rrjeti Rrugor Rural	26
3.1.9 Menaxhimi i mbetjeve.....	26
3.1.10. Planifikimi Urban Vendor.....	27
3.1.11. Shërbimet Publike Vendore	28



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

3.1.12. Furnizimi me Ujë	28
3.1.13. Sport dhe Argëtim.....	29
3.1.14. Arsimi Bazë dhe Parashkollor	29
3.1.15. Arsimi i Mesëm.....	30
3.1.16. Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët	30



HYRJE

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Vorë ka një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, duke qënë një nyje mjaft e rëndësishme në kryqëzimin e rrugëve kryesore automobilistike dhe hekurudhore, ndodhet 5 km nga aeroporti kombëtar, ai i Rinasit, 16 km nga Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana dhe 20 km nga porti i Durrësit. Ka një sipërfaqe rreth 82.72 km², ku përfshin dy njësi administrative Prezë dhe Bërçullë, me një densitet popullsie sipas regjistrimit civil, është 438 banorë/km². Vora e sotme përbëhet nga nëntë qendra të banuara të madhësive të ndryshme, secila me veçoritë e tyre. Është e vështirë të theksosh këto tipare për secilën prej tyre pasi shpesh ato përmbledhin zona më të gjëra, që shkojnë përtej kufinjve administrative në hapësirë dhe kohë. E megjithatë këto qendra që së bashku formojnë njësinë vendore të Vorës dhe kanë veçori që mund të shërbejnë për orientimin e zhvillimeve të së nesërme. Këto Njëmbëdhjetë Qendra janë Kuci, Gjokaj, Marqineti, Gërdeci, Sharga, Marikaj, Kodër Vorë, Picari, Prezë Domje, Bërçull.

Bashkia Vorë karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike, përbëhet nga bizneset e vogla, të cilat janë edhe katalizatorë të zhvillimit, pasi krijimi, zhvillimi dhe përmirsimi i këtyre bizneseve përbën një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik.

Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh. Si një karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Në territorin e bashkisë Vorë gjenden 18 struktura (objekte) arsimore, nga të cilat 3 (tre) janë shkolla të mesme të përgjithshme, 9 (nëntë) janë shkolla 9-vjeçare dhe 6 (gjashtë) arsim para-shkollor (kopësht).

Pranë zyrave të bashkisë Vorë janë regjistruar gjithsej 1703 biznese nga të cilat 717 (rreth 42 %) të llojit Biznes i Madh dhe pjesa tjetër (rreth 58 %) Biznes i vogël 986. Nga të dhenat në INSTAT vihet re se Qyteti i Vorës mbizotëron me numrin total të bizneseve, rreth 240 subjekte (32 %), por është fshati Gjokaj ai që ka numrin më të madh, rreth 120 subjekte (16 %), të regjistruar si Biznes i Madh. Ndërkohë shifrat më të ulëta në total arrijnë në fshatrat Gërdec, Kuç dhe Shargë (4,4 dhe 15 respektivisht).

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës së vitit 2024

- 30 % janë të punësuar në sektorin Publik.
- 70 % janë të punësuar në sektorin privat.

2.1. Pikat e Forta

- Pikë e fortë konsiderohet një burim (natyror, financiar, human), mjeshtëri apo kompetencë dalluese të cilën njësi mund ta përdorë për të forcuar pozitën e vet.
- Pozicioni Gjeografik Vendodhja në koridor ekonomik.
- Prezenca e popullsisë së re Dendësi e ulët e popullsisë në raport me rajonin, hapësirë vakante Traditë prezenca e disa bizneseve.



- Përqindja e krijimit të bizneseve të reja Produkte bujqësore cilësore Peizazh mesdhetar i pasur nga këndvështrimi mjedisor.
- Tërheqja e familjeve të reja duke ofruar strehim më ekonomik.
- Zhvillimi i turizmit alternativ dhe agroturizmit Identifikimi i potencialeve territoriale dhe aktivizimi i vlerave të tyre.
- Afërsia fizike mes bizneseve të të njëjtit sektor mund të shërbejë për gjenerimin e ekonomive në të ardhmen.

2.2. Pikat e Dobëta

- Pikë e dobët konsiderohet mungesa e burimeve, mjeshtërive apo kompetencave dalluese të cilat dëmtojnë pozitën e njësisë.
- Infrastruktura shërben si barrierë (autostrada) Ndotje e lartë mjedisore dhe akustike Sistem vaditës i amortizuar.
- Mbledhje e taksave në masë të ulët Mungesë e hapësirave publike dhe të gjelbra.
- Pamjaftueshmëri e shërbimeve publike.
- Rritje e varfërisë dhe përjashtimit social sidomos sa i përket moshës së tretë.
- Lidhje jo e mirë mes zonave rezidenciale dhe vendeve të punës.
- Pamjaftueshmëri e jetës sociale.
- Fragmentarizim i pronësisë mbi tokën Identitet i paqartë i hapësirës së qendrave urbane.
- Mungesë informimi dhe komunikimi publik.

2.3. Mundësitë

Mundësi konsiderohet një situatë e mjedisit të jashtëm që favorizon pozitën e njësisë.

- 1-Kërkesë në rritje për strehim
- 2-Zonë potenciale si pika doganore e Tiranës
- 3-Zonë potenciale për një pol të ri shërbimesh spitalore dhe shëndetsore
- 4-Rifunksionalizmi eventual i hekurudhës.

2.4.Kërcënimet

Kërcënim konsiderohet një situatë e mjedisit të jashtëm që kërcënon pozitën e njësisë.

- 1-Konkurueshmëri e lartë në rajon nga njësitë fqinje
- 2.Përmisimi i aksit Tiranë -Durrës (Zhvendosje potenciale e bizneseve në drejtim të zonës lindore të qytetit)
- 3.Degradim i mjedisit natyrore dhe rrisku në rritje i erozionit
- 4.Zonë me aktivitet sizmik të lartë.
- 5.Objektivat strategjikë, programet kryesore të zhvillimit dhe plan veprimi për 3-vjeçarin e ardhshëm

1.3. Perspektiva e financave vendore

Më lart dalluam potencialin financiar të Bashkisë Vorë, ndërkohë që zhvillimi hapësinor perspektiv i Bashkisë dikton transformimin e politikave të zhvillimit ekonomik, social, urban në aktivitete dhe projekte konkrete, realizimi të cilave tashmë do të orientojë një dinamikë të re financiare të Bashkisë. Në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe hapësinor, përbërësit kryesorë shihen të lidhur ngushtësisht me tendencat e zgjerimit të qytetit por edhe me një tendencë në rritje të zhvillimit të biznesit. Referuar asaj që kemi trajtuar më sipër, ndonëse struktura e bizneseve shkon në favor të biznesit të vogël (i cili



përbën 60% të totalit të bizneseve në Bashki) kjo tendencë vlerësohet ndër më pozitivet në rajon. Në Bashkinë Vorë operojnë 717 biznese të mëdha dhe 986 biznese të vogla.

1.4-Fushat prioritare ku do të përqëndrohet puna e Bashkisë për vitin 2024 paraqiten si vijon:

➤ Zhvillimi ekonomik vendor

Qëllimi i këtij programi është krijimi dhe zhvillimi i një mjedisi ekonomik në mënyrë të tillë që jetësa të jetë me atraktiv dhe konkurrues, i cili do të konsolidojë dhe garantojë qëndrueshmërinë ekonomike gjatë një periudhe afatmesme. Programi i zhvillimit ekonomik përpiket të bëjë bashkërendimin e planeve dhe politikave buxhetore me nevojat ekonomike të Bashkisë Vorë.

Në këtë fushë përfshihen angazhime të tilla si përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomiko- vendor, zhvillimi i biznesit të vogël dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse. Gjithashtu organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik si informacioni, struktura dhe infrastruktura përkatëse. Avantazhi i pozicionit gjeografik si edhe shumë avantazhe të tjera tregojnë për një rritje dinamike të zhvillimit të bizneseve, thithje të investimeve vendase dhe të huaja, në sajë të përmisimit dhe të infrastrukturës nga ana e bashkisë Vorë.

➤ Infrastruktura rrugore

Investimet në këtë program do të përmbushin impenjimet e Kryetarit, për rehabilitim të rrugëve, duke aplikuar standartet më të larta, në gjithë territorin e Bashkisë Vorë. Duke i dhënë përparësi sigurisë në rrugë, gjatë vitit të ardhshëm do të synohet rikualifikimi tërësor i gjithë infrastrukturës horizontale dhe vertikale. Në kuadër të reformës administrative dhe zgjerimit të territorit të Bashkisë Vorë, vitin e ardhshëm shumë investime do të jenë të përqëndruara edhe në njësitë administrative, si dhe do të përfundohen investimet e nisura në këto zona.

➤ Shërbimet publike.

Në përmbushje të qëllimit të politikës, objektiva të këtij programi fokusohen në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara si dhe përmirësimi cilësor i shërbimit e kapaciteteve të pastrimit të qytetit dhe zonës. Krijimi i hapësirave etno-kulturore dhe natyrore të mbrojtura, si dhe ndërtimi i pallateve nga shteti për banorët e mbetur të pa stre nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019.

Gjatë vitit të ardhshëm do të rikonceptohen dhe strukturohen zonat dhe shërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Vorës, duke bërë edhe diferencimin e mbetjeve urbane, duke i dhënë përparësi kështu riciklimit.

➤ Shërbimet me karakter social kulturor dhe sportiv.

Kujdesi Social është gjithashtu një prioritet, duke synuar përmirësimin e jetës së çdo qytetari. Ardhja në ndihmë nëpërmjet ndihmave financiare për njerëz dhe familje në nevojë, si dhe për ato që vuajnë nga sëmundje të rrëzikshme është një ndër angazhimet e bashkisë edhe për vitet e ardhshme.

Sigurimi i mbulimit të plotë të nevojave ekonomike dhe sociale të familjeve dhe individëve të qytetit të Vorës, duke i riintegruar përfituesit në ambientin shoqëror, duke harmonizuar programet e mbrojtjes dhe të zhvillimit social, duke i transformuar në një instrument aktiv të zhvillimit shoqëror është qëllimi i këtij program.

Në fushën e shërbimeve me karakter kulturor dhe sportive synohet: ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimi i veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse. Gjithashtu organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse dhe argëtuese do të jetë një nga prioritetet tona.

➤ Struktura e Programit Buxhetor



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Projekt-Buxheti është hartuar në bazë të programeve të përcaktuara me ligj për vetqeverisjen vendore. Bashkia Vorë aktualisht përfshin 18 programe buxhetore të listuara si më poshtë:

Nr.	Kod Programi	Emërtimi i Programit
1	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi
2	01170	Gjendja Civile
3	03140	Shërbimet e Policisë Vendore
4	03280	Mbrojtja nga Zjarri
5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi dhe Ushqimi
6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit
7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave
8	04520	Rrjeti Rrugor Rural
9	05100	Menaxhimi i mbetjeve
10	06140	Planifikimi Urban Vendor
11	06260	Shërbimet Publike Vendore
12	06370	Furnizimi me Ujë
13	08130	Sport dhe Argëtim
14	09120	Arsimi Bazë dhe Parashkollor
15	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm
16	04980	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencë
17	10910	Mbrojtja Civile
18	10661	Shërbimet Sociale, (Bonus qera nga të ardhurat)

KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor që rregullon procesin e hartimit të buxhetit vendor përshkruan qartë se si duhet të organizohet procesi i buxhetimit duke përfshirë zbatimin e buxhetit dhe monitorimin e tij. Kjo kornizë bazohet te:

- **Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**
- **Ligji Nr. 68, datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;**
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.57, datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
- Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 34 të ligjit nr.68/2017 datë 27.04.2017 datë 27.04.2017 " Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat stadarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NjQV"
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë NR.6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" dhe shtojcat plotësuese,
- Udhëzimin plotësues nr.21, datë 07.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026

Gjatë këtij viti me Misionin tonë: *“Planifikim dhe menaxhim me ekonomi, eficence dhe efektivitet të shpenzimeve Publike, dhe në fund ndërtohet që ti shërbej Qytetarit”.*

-Burimi i të ardhurave

Arsyet/Faktoret në planifikimin e të ardhurave ndër vite. Financimi i buxhetit realizohet nga:

- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike (e pakushtëzuar sektoriale) për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat, nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifatat vendore, dhe të ardhurat e tjera Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
2. Ligjin Nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
3. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Vorë, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Vorës ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.




PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

NR.	EMËRTIMI	PLANI VITI 2024	PLANI VITI 2025	PLANI VITI 2026
I	TË ARDHURAT E VETA	662,287,000	692,257,601	723,726,730
1	Taksa Lokale	292,468,000	306,697,650	321,638,783
2	Të Ardhura nga Tarifa lokale	225,571,750	236,850,338	248,692,854
3	Të Ardhura të Tjera Jo-Tatimore	144,247,250	148,709,613	153,395,093
II	TË ARDHURA NGA BËRIMET QËNDRORE	284,414,000	260,687,300	267,105,000
1	Transferta e pakushtëzuar për Aparatin e Bashkisë Vorë për vitin 2024	173,293,000	153,500,000	157,350,000
2	Trasferta e pakushtëzuar Menaxhimi i Mbetjeve për vitin 2024	24,589,000	24,700,000	25,300,000
3	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Arsimin Parashkollor për vitin 2024	52,613,000	49,930,000	51,200,000
4	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Arsimin Parauniversitar për vitin 2024	6,068,000	5,600,000	5,740,000
5	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Sherbimin mbrojtja nga zjarri(PMNZSH) për vitin 2024	15,037,000	14,320,000	14,500,000
6	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Administrimin e pyjeve për vitin 2024	1,054,000	987,000	1,100,000
7	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Rruget Rurale për vitin 2024	601,000	550,300	565,000
8	Transferta e pakushtëzuar Sektoriale për Ujitjen dhe Kullimin për vitin 2024	11,159,000	11,100,000	11,350,000
III	TRANSPERTIA NGA BËRIMET QËNDRORE PËR INVESTIME RINDËRTIMI	90,713,852	63,462,113	65,048,666
1	Financim për Rindertimin e Godines se Bashkie	62,217,758	63,462,113	65,048,666
2	Të ardhura nga Garanci të ngurtësuar	28,496,094	-	-
IV	TRANSPERTË NGA BËRIMET QËNDRORE PËR GJENDJEN CIVILE	4,920,000	4,920,000	4,920,000
1	Trasferte e Kushtëzuar (Pagat e Gjendjes)	4,920,000	4,920,000	4,920,000
TOTALI (SHUMA I + SHUMA II+SHUMA III+SHUMA IV)		1,042,334,852	1,021,327,014	1,060,800,396



PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE 2024-2026



Plani i Vitit 2024 Plani i Vitit 2025 Plani i Vitit 2026

Buxheti i Bashkisë Vorë për vitin 2024 parashikohet të jetë një buxhet i balancuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe transferta për fondet e rindërtimit. Ai është projektuar në vlerën **1,042,334,852** lekë.

2.1. Të Ardhurat e Veta

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha të ardhurat që vinë nga taksat, tarifat dhe burime të tjera jotatimore. Këto të ardhura bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara me ligj për njësitë e qeverisjes vendore. Veprimtaria e Bashkisë Vorë në fushën e sistemit fiskal vendor funksionon mbështetur në bazën ligjore, si më poshtë:

- Ligji nr.9920, datë 26.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar
- Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për Miratimin e paketës fiskale për vitin 2024”.



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat për vitin 2024 është i mbështetur në Paketën Fiskale të Bashkisë Vorë, në të cilën përcaktohen llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua në sajë të frymës së bashkëpunimit me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxullë. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Të Ardhurat e Veta e parashikuara për vitin 2024 janë 662,287,000 lekë ose 65 % e totalit të të ardhurave të Bashkisë Vorë. Këto të ardhura detajohen si më poshtë:

2.1.1. Të ardhurat nga taksat vendore

Bashkia garanton funksionimin e saj duke përfutur burime financimi kryesisht nga taksat vendore të miratuara sipas akteve ligjore të Këshillit Bashkiak

Për vitin fiskal 2024 këto të ardhura planifikohet të arrijnë në shumën 518,039,750 lekë ose 78 % të totalit të të Ardhurave të Veta.

Të ardhurat e nga taksat vendore të parashikuara për tu mbledhur në buxhetin e vitit 2024 paraqiten të detajuara si më poshtë:

a. Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006" "Për sistemin e taksave vendore", neni 11 ndryshon dhe:


- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë,
- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të Bashkisë Vorë. Për shkak të fatkeqësisë natyrore që pësoi vëndi jonë dhe më pas pandemia qeveria në bazë të udhëzimit që nxorri në Fletore Zyrtare me nr.122/2020 vendosi që për të gjithë Bizneset e vogla kjo takse të bëhet Zero. Për këtë arsye për vitin 2024 nuk është parashikuar si e ardhur në Paketë Fiskale.

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël	0	0	0	0	0

b. Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari,



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshijnë:

- Taksën mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera);
- Taksën mbi tokën bujqësore ;
- Taksën mbi truallin.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vinë nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa mbi ndërtesat	113,286,091	139,250,000	146,212,500	153,523,125	161,199,281
Taksa mbi tokën bujqësore	5,751,250	7,875,000	7,875,000	7,875,000	7,875,000
Taksa mbi truallin	16,724,336	19,290,000	20,254,500	21,267,225	22,330,586

c. Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel

Çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vinë nga taksa e fjetjes paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa e fjetjes në hotel	358,995	350,000	500,000	525,000	551,250

d. Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja

Në këtë taksë përfshihen edhe të ardhurat e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i legalizimit. Në parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë është llogaritur që vlera prej **84,141,000** lekë vlerë e cila mendojmë që të realizohet nga procesi i legalizimit të objekteve pa leje në territorin e qytetit të Vorës dhe në të gjithë fshatrat për rreth, njëkohësisht edhe në njësinë Prezë dhe Bërksullë si dhe mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja.



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Vorë. Bazuar në ligjin nr.9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3 % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet. Bazuar në Ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vinë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	76,573,441	70,610,479	84,141,000	88,348,050	92,765,453

e. Të ardhura nga taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Vorë. Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor, i cili është bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	9,502,153	8,400,000	5,000,000	5,250,000	5,512,500

f. Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të automjeteve

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, mblihet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (drejtoritë rajonale) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësjive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në

PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 18 % e të ardhurave vjetore.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga taksa e regjistrimit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa e regjistrimit të automjeteve	2,209,490	7,350,000	12,000,000	12,600,000	13,230,000

g. Të ardhura nga taksa e tabelës.

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

- Tabela për qëllime identifikimi
- Tabela për qëllime reklamimi
- Tabela për qëllime ekspozimi

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga taksa e tabelës paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Taksa e tabelës	10,445,776	15,700,000	16,485,000	17,309,250	18,174,713

2.1.2. Të ardhurat nga tarifat vendore

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjithë të ardhurat me natyrë jo tatimore, që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve publike, të drejtat e përdorimit të pronave publike dhe vendore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve etj. Këto të ardhura zëne rreth 29.99 % të të ardhurave të veta të bashkisë. Për vitin 2024 planifikimi i këtij zëri është në vlerën **225,571,750** lekë.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikën dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Parashikimi i të ardhurave nga biznesi bëhet duke u bazuar në kapacitete, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin. Më poshtë po japim planifikimin sipas zërave të këtij grupi të ardhurash.

PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifa, paguhet nga të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Vorë. Kjo tarifë është vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht bëhet brenda 20 Prillit të çdo viti. Bashkia vijon të përballet me evazionin fiskal të të ardhurave por pavarësisht kësaj një pjesë e mirë e shërbimeve publike vazhdon të financohet nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa për shërbimet publike (Pastrim+Ndotje Ambjenti)	54,394,061	59,000,000	61,950,000	65,047,500	68,299,875

b. Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë

Në këtë grup të ardhurash bëjnë pjesë të gjitha shërbimet që ofron bashkia :

- Të ardhura nga Tarifa e kontrollit të zhvillimit të territorit
- Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinarë të bagëtive të therura
- Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit
- Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri
- Të ardhura nga Tarifa e ujit

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga tarifa administrative paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	585,240	1,300,000	1,365,000	1,433,250	1,504,913

c. Të ardhurat nga tarifa për leje transporti

Për dhënie të lejeve të transportit të udhëtareve dhe të mallrave dhënia e shumës së liçencës është 5 (pesë) vjecare kurse e certifikatës është vjetore e ndarë sipas subjekteve Person juridik dhe Person fizik. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga tarifa për leje transporti paraqiten si më poshtë:



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa për leje transporti	1,716,705	3,575,000	3,753,750	3,941,438	4,138,509

d. Tarife për shitje toke

Për kompletimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar në rastin e shitjes së tokës bujqësore, procedura kjo e realizuar nga sektori i Bujqësisë si dhe për shërbime të tjera të ofruara nga kjo zyrë për këtë proces, është planifikuar tarifa për shitjen e tokës bujqësore.

Kjo tarifa paguhet në momentin e shitjes së tokës bujqësore. Pala shitëse në momentin e deklarimit të shitjes paguan, në bazë të kategorisë së tokës.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga tarifa për shitje toke paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa për shitje toke	9,502,153	3,650,000	3,650,000	3,832,500	4,024,125

e. Tarifa e ndriçimit

Kjo tarifë gjithashtu është vjetore dhe likujdohet sipas kategorizimit “biznes” dhe “familjare”.

Për Bashkinë Vorë parashikimi për të ardhurat që vijnë nga tarifa ndriçimit paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa ndriçimit ^e	4,603,685	5,200,000	5,460,000	5,733,000	6,019,650

f. Tarifë për hapësirat publike

Kjo tarifë paguhet për zënie të hapësirave publike për qëllime biznesi. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Niveli tregues i tarifës së hapësirës publike është:

- Hapësira publike brenda pedonale (Qendra e qytetit Vorë) - 1000 lek/tavolinë/ditë
- Hapësira publike jashtë pedonale - 100 lek/tavolinë/ditë
- Zënia e hapësirës publike nga automjetet përkatëse të subjekteve - 66 lek/m²/muaj



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa për hapsirat publike dhe Parkim	0	300,000	540,000	567,000	595,350

2.1.3. Të ardhura nga burime të tjera

Për këtë zë të të ardhurave për vitin fiskal 2024 është parashikuar një shumë prej 144,247,250 lekë ose 13.77% të totalit të të ardhurave të veta dhe përfshijnë :

- Të ardhura nga kundërvajtjet administrative
- Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi të bashkisë
- Detyrime të prapambetura
- Të tjera (aluizmi, gjoba)

Emërtimi	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Tarifa nga burime të tjera	24,774,909	93,641,250	144,247,250	148,709,613	153,395,093

Strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre taksave dhe tarifave, të vendosura dhe të miratuara në Paketën Fiskale 2024, janë sektorët dhe drejtoritë përkatëse e Bashkisë Vorë.

2.2. Të ardhurat nga burimet qendrore

Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar dhe transfertat specifikë niveli i të cilave përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit. Në mënyrë të detajuar të ardhurat e parashikuara për vitin 2024 nga burimet qendrore paraqiten si më poshtë:

Të Ardhurat nga Burimet Qendrore	Viti 2024
Transferta e pakushtëzuar	173,293,000
Transfertat e pakushtëzuara sektoriale (transferta specifikë)	111,121,000
	0
TOTALI	284,414,000

Të ardhurat nga burimet qendrore janë parashikuar të jenë për vitin 2024 **284,414,000** ose 60% e totalit të buxhetit.

2.2.1. Transferta e Pakushtëzuar

Transferrat e pakushtëzuara, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo transfertë është një e ardhur e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi dhe pa interes. Transferrat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësisve të pushtetit vendor, sipas formulës së përcaktuar. Bashkitë, duhet të përdorin jo më pak se 40% të transfertës së pakushtëzuar, për investime publike.

Rritja vjetore e transfertës së pakushtëzuar parashikohet në udhëzimin vjetor të Ministrisë së Financave “Për hartimin e buxhetit vendor”. Transferta e pakushtëzuar për vitin buxhetor që planifikohet, njoftohet nga Ministria e Financave përpara hartimit të buxhetit të vitit.

Për vitin 2024, transfertat e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë (shkresa Nr. 20079, datë 03.11.2023) për Bashkinë Vorë shuma totale është lekë ose 60 % e totalit të të ardhurave nga burimet qëndrore.

2.2.2. Transferrat e pakushtëzuar sektoriale (specifike)

Transferrat specifike janë transfertat të cilat janë alokuar nga Qeveria për financimin e shpenzimeve për funksionet e reja që i janë transferuar bashkisë. Në këtë fond për arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, për administrimin e pyjeve dhe për ujitje dhe kullimin. Transferta e pakushtëzuar sektoriale përfshin fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës ndihmës dhe edukatorët) si dhe shpenzimet operative për disa nga funksionet.

Konkretisht për vitin 2024 transfertat specifike, në bazë të ligjit për buxhetin e shtetit dhe sipas planit të hapur nga Ministria e Financave, Bashkisë Vorë duhet të financohen nga Ministria e Financave transfertat specifike të mëposhtme:

Nr	Emërtimi i Transfertës Specifike	Nr. Punonjësve	Shpenzime Personeli(600+601)	Fondi i veçantë	Shpenzime Korrente(602-609)+Të Trashëguarat	Totali
1	Arsimi parashkollor	49	44,137,058	1,975,942	6,500,000	52,613,000
2	Arsimi i mesem	7	5,807,986	260,014		6,068,000
3	Mbrojtja nga zjarri	19	14,392,665	644,335		15,037,000
4	Administrimi i pyjeve	1	1,008,836	45,164		1,054,000
5	Rrugët Rurale	2	1,080,336	39,984		1,120,320
6	Ujitje -Kullim	1	575,247	25,753	10,038,680	10,639,680
	TOTALI	79	67,002,128	2,991,192	16,538,680	86,532,000

Transferta e pakushtëzuar sektoriale zë 30 % të totalit të të ardhurave nga burime qëndrore.

2.2.3. Transferta e Kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar jepet për financimin e një pjese të shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Transferta e kushtëzuar përbëhet nga



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtarë të rregjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, për personat me aftësi të kufizuar. Këto fonde përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë miratuar.

Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund ti përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ligjin për buxhetin. Shumat e këtyre transfertave, të mbetura të papërdorura në fund të vitit buxhetor, nuk mbarten në vitin pasardhës, por rikthehen në buxhetin e shtetit.

Emërtimi	Transferta e Kushtëzuar 2024
Gjendja Civile	4,920,000
Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia	132,708,000
TOTALI	137,628,000

Transferta e kushtëzuar zë 32% të totalit të të ardhurave nga burime qendrore.

2.2.4. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet plotikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurrese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. FZHR-ja mbështetet në tre shtylla kryesore: Programi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale Vendore; Programi i mbështetjes për ekonominë dhe Programi “Shqipëria dixhitale”. Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë fonde për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë. Projektet miratohen nga Komuniteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë, i cili përcakton dhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore. Komiteti merr vendime bazuar në raportet e sekretariateve teknike të Ministrive të Linjës, të cilat bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në VKM nr.135, datë 03.02.2010 për “Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”.

• STRUKTURA E BASHKISË PËR VITIN 2024

Administrata është një faktor i rëndësishëm në qeverinë vendore, ajo duhet motivuar, vlerësuar dhe duhet investuar gjithmonë në rritjen profesionale të saj. Përcaktimin dhe vlersimin real i strukturës dhe nivelit të pagave që aplikohet për punonjësit e Administratës së Bashkisë Vorë, do të sjellë një funksionim, përkushtim dhe përgjegjshmëri më të mirë të punonjësve në shërbim të qytetarëve. Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ku shprehet në nenin 64 për kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, shkronja “j” Miraton strukturën, organikën, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së Bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 54, Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, shkronja “ç” miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vendim I Këshillit të Ministrave Nr. 328, datë 31.05.2023 Për “Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve Administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”



PROGRAMI BUXHETOR 2024-2026

Vendimi Nr. 325, datë 31.05.2023, Për Miratimin e strukturës së pagave , nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendës Ministrit , funksionarëve të kabineteve, Prefektit Nënprefektit ,Nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, Lidhja nr 1 , për Nëpunësit e Gjëndjes Civile.

Vendimi Nr. 241, datë 20.04.2023, Për një ndryshim në Vendimin Nr.175, dt. 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

Vendimi Nr.627, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 234, datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

Vendimi nr 240 datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr 350 datë 19.04.2017 të Këshillit të Ministrave për “ trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 113, datë 01.03.202 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

Numri Total i Punonjësve të Bashkisë është 478 punonjës dhe detajohet si më poshtë:

NR.	EMERTIMI	TOTALI
1	Numri i Punonjesve Bashkia Vorë	418
2	Numri i Punonjesve Njësia Administrative Prezë	30
3	Numri i Punonjesve Njësia Administrative Bërxullë	30
	TOTALI	478

KAPITULLI III. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024

Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Bashkisë Vorë për vitin 2024 parashikohet në vlerën 1,042,334,852 lekë. Bashkia Vorë në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve në këtë buxhet synon:

- Transparencën, gjithëpërfshirjen, unitetin dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor e te fondeve speciale.
- Disiplinë fiskale në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje vlerësimin e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit, të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.
- Rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes në shërbimet publike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë tendencës të rritjes së investimeve në vite.
- Duke paraqitur një buxhet të balancuar (pa defiçit) të ardhurat = shpenzimet, dhe të besueshëm.
- Kontrolli i angazhimeve shumëvjeçare.
- Gjithëpërfshirës dhe në koherencë me nevojat e qytetarëve

3.1. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

3.1.1. Shpenzime kapitale

Shpenzimet kapitale përfshijnë investimet afatgjata të cilat Bashkia Vorë ka vendosur të përfshijë në PBA 2024 – 2026. Shpenzimet Kapitale për vitin 2024 parashikohen të jenë 311,199,832 lekë ose në terma relativ 41 % e totalit të buxhetit. Shpenzimet kapitale parashikohen të financohen si më poshtë:

- ✓ 311,199,832 lekë ose 100 % e shpenzimeve kapitale nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

3.1.2. Shpenzime korente

Shpenzimet korente përbëhen nga: shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore të bashkisë. Gjithashtu janë të përfshira edhe shpenzimet për funksionet e deleguara nga transfertat e kushtëzuar, specifike dhe e pakushtëzuar.

Shpenzimet korente për vitin 2024 parashikohen në shumën 398,661,052 lekë.

a. Shpenzimet korente për paga dhe sigurime

Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) për funksionet veta dhe të deleguara të planifikuara për vitin 2024 është 332,473,968 lekë ose 59 % e totalit të buxhetit.

Këto shpenzime do të financohen si më poshtë:

- Nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar: **241,021,968** lekë ose **72 %** e totalit të shpenzimeve të personelit;
- Nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale (specifike): **69,993,320** lekë ose **26 %** e totalit të shpenzimeve të personelit;
- Nga transfertat e kushtëzuar: **4,920,000** lekë ose **1%** e totalit të shpenzimeve të personelit.

b. Shpenzime operative

Për vitin 2024 në total shpenzimet operative janë projektuar në shumën **338,100,252** lekë, këto shpenzime zënë 21.3 % të totalit të buxhetit. Peshën më të madhe në këtë zë e kanë kontratat e pastrimit dhe menaxhimi i mbetjeve (22% e totalit të shpenzimeve operative)

Këto shpenzime do të financohen si më poshtë:


- Nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar: **321,561,572** lekë ose **95 %** e totalit të shpenzimeve operative;
- Nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale (specifike): **16,538,680** lekë ose **0.4 %** e totalit të shpenzimeve operative.

3.1.3. Fondi rezervë dhe kontigjenca

Fondet speciale (Fondi rezerve dhe Fondi Kontigjence) janë parashikuar në vlerën **8,355,800** lekë dhe kanë peshë specifike deri 2.3 % të totalit të buxhetit duke i zbritur transfertin e kushtëzuar ose 2% e totalit të Buxhetit. Ky zë përlllogaritet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

3.1.4. Mbrojtja Civile

